



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

“AUDITIMIN FINANCIAR”

Tiranë, tetor 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projekt Raportit të Auditimit	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	7-10
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit.	7
2.	Identifikimi i çështjes.	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve.	7-8
5.	Kriteret e vlerësimit.	8
6.	Standardet e auditimit.	8
7.	Metoda e auditimit.	8-9
8.	Dokumentimi i auditimit.	9-10
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11-47
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	11
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	11-47
2.1.	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.	11-20
2.2.	Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.	20-43
2.3.	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	43-47
2.4.	Të tjera çështje përgjatë auditimit.	47
IV.	REKOMANDIME	48-52

Shkurtime

AAGJM	Aktive Afatgjata Materiale
AAJM	Aktive Afatgjata Jomateriale
AB	Auditi i Brendshëm
AK	Autoriteti Kontraktor
AMTP	Aktit Marrjes së Tokës në Pronësi
APP	Agjensia Prokurimeve Publike
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DST	Dokumentet Standarte të Tenderit
EMP	Ekipi menaxhimit të programeve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
HRMIS	Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
IDI	Nisma për Zhvillimin e INTOSAI-t
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologji Informacioni
IVMT	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
KB	Kontrolli i Brendshëm
KB	Këshilli Bashkiak
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KR	Koordinatori Riskut
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MF	Ministria e Financave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MR	Menaxhimi i Riskut
NA	Nëpunës Autorizues
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator ekonomik
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PP	Prokurime Publike
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar Qeveritar
SKK	Standarti Kombëtar i Kontabilitetit
SNK	Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit
SNKSP	Standarti Ndërkombëtar i Kontabilitetit në Sektorin Publik
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

a. Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit.

Bashkia e Delvinë është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale përbëhet nga ish komuna Vergo dhe Qendra Delvinë, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative, me qendër në qytetin Delvinë. Bashkia e Delvinës ka një shtrirje territoriale prej 182.9 km² dhe kufizohet me Bashkitë Finiq, Sarandë, Himarë, Dropull dhe Gjirokastrë.

Misioni i Bashkisë Delvinë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Delvinë, si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij subjekti është auditim i radhës, sipas planit vjetor të miratuar në fillim të vitit 2025, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit dhe në vijim të rëndësisë që ka auditimi i njësisë të vetëqeverisjes vendore sipas detyrimeve që lindin nga kërkesat e ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Gjithashtu, ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Delvinë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Delvinë për periudhën e aktivitetit nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, sipas legjisllacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së bashkisë.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionimi nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm.
- Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
- Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 9 gjetje dhe ka dhënë 9 rekomandime, nga të cilat 8 masa organizative dhe 1 masë për arkëtim të detyrimeve tatimore.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- nga auditimi rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifatat vendore, që në fund të vitit 2024 janë në shumën 93,304,193 lekë, me rritje krahasuar me vitin 2023, ku vlera debitorëve është 90,254,844 lekë. Kjo rritje vjen kryesisht nga detyrimet debitorë nga biznesit i madh dhe i vogël, të cilat kanë një rritje **në shumën 13,118,668 lekë**, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Delvinë;

- Bashkia Delvinë ka në administrim një fond pyjor dhe kullësor prej 12,852¹⁶ ha për 391 prona të trasferuara, referuar listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave të miratuar me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar. Konstatohet se, në Zyrën Vendore të ASHK Sarandë rezultojnë se janë çelur kartela të pasurive të paluajtshme për 416 pasuri pyje dhe kullota dhe për të cilat bashkia ka aplikuar vetëm për 9(nëntë) pasuri, pra rezulton një proces me ecuri të ngadaltë;

- në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2024, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, paraqitet në vlerën kontabël 12,163,708 lekë, e rakorduar me degën e thesarit dhe përbëhet nga 16 subjekte. Nga auditimi rezulton se, gjatë vitit 2024 janë plotësuar afatet kontraktuale për likuidimin të vlerës së garancisë në shumën 2,095,237 lekë. Referuar veprimeve të ditarit të marrëdhënieve me thesarin rezulton se gjatë vitit është likuiduar shuma 1,273,002 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 822,235 lekë;

- nga 14 masa gjithsej të rekomanduara dhe të pranuar nga subjekti, janë realizuar 7 masa, janë në proces 3 masa, janë realizuar pjesërisht 2 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa;

- nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe nuk funksionon auditi i brendshëm

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- të merren masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët e vitit 2024 në shumën **13,118,668 lekë**, si dhe të vijojë të ndjekë të gjitha rrugët e ligjore për arkëtimin e debitorëve gjithsej për taksat e tatime në shumën 93,304,193 lekë;

- të merren masa të menjëhershme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie;

- të merren masa për të zbatuar procedurat ligjore për likuidimin e vlerës 822,235 lekë, sipas subjekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësinë vendore, të evidentuara në llogarinë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

- me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të merren masa për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të kontrollit të brendshëm;
- të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Delvinë dhe ndërkohë në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mendësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëres nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikatat e ngjashme nga bashki të tjera.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinionit për auditimin financiar: Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Delvinë, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese, si dhe të gjitha pasqyrat statistikore që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinionit:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2024, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, Udhëzimin e MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022. etj.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI.

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë të pozicionit financiar më 31.12.2024.. Për këto arsye kemi dhënë **opinion të pamodifikuar me theksim çështje**¹ : , sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 8,105 mijë lekë. Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Delvinë, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mospërputhje me Udhëzimin e MF nr. 8, datë

¹ **Opinionit i pamodifikuar me theksim çështjeje.** Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t’i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit.

09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, sipas përshkrimit të çështjes së mëposhtme:

- Bashkia Delvinë ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 12,852.16 ha për 391 prona të transferuara, referuar listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave të miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016, i ndryshuar. Konstatohet se, në Zyrën Vendore të ASHK Sarandë rezultojnë se janë çelur kartela të pasurive të paluajtshme për 416 pasuri pyje dhe kullota dhe për të cilat Bashkia Delvinë ka aplikuar vetëm për 9(nëntë) pasuri, pra rezulton një proces me ecuri të ngadaltë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 622/1prot., datë 30.05.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 05.06.2025 deri në datën 07.07.2025, në subjektin Bashkia Delvinë u krye “Auditimi Financiar” për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S. B., Përgjegjës Grupi;
2. A. V., anëtar,
3. K. F., anëtar,
4. A. C, anëtar.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “*Kriteret e vlerësimit*”. Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Delvinë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes.

Auditimi synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Delvinë dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Referuar programit të auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm.
- Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
- Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të Bashkisë Delvinë, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së bashkisë, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

4. Përgjegjësitë e audituesve. Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Delvinë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Delvinë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligjet vjetore të buxhetit të shtetit;
- VKM-të dhe Aktet Normative mbi funksionimin dhe organizimin e institucionit;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH^{së}”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH^{së}”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë.

6. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI -t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH.

7. Metoda e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i

mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuan në zyrën e protokollit të Bashkisë Delvinë në datë 07.07.2025, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit dhe mbi bazën e këtyre dokumenteve u përgatit Projekt Raporti i Auditimit. Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur kundërshti për aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia e Delvinë është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale përbëhet nga ish komuna Vergo dhe Qendra Delvinë, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative, me qendër në qytetin Delvinë. Bashkia e Delvinës ka një shtrirje territoriale prej 182.9 km² dhe kufizohet me Bashkitë Finiq, Sarandë, Himarë, Dropull dhe Gjirokastrë.

Misioni i Bashkisë Delvinë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Delvinë, si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

Auditimi i këtij subjekti është auditim i radhës, sipas planit vjetor të miratuar në fillim të vitit 2025, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit dhe në vijim të rëndësisë që ka auditimi i njësisë të vetëqeverisjes vendore sipas detyrimeve që lindin nga kërkesat e ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Gjithashtu, ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Delvinë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe auditit të brendshëm.

a) Mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

Auditimi i këtij drejtimi të programit u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;

- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Delvinë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Delvinë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Urdhrin nr. 1322, datë 28.05.2020 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Delvinë”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

Kodi Etikës është i përfshirë në Rregulloren e Brendshme por nuk është miratuar një kod i veçantë etike.

Bashkia nuk ka procedurë të shkruara për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj sepse nuk ka patur rate të tilla.

- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se për vitin 2024, me urdhrin nr. 666prot., datë 18.03.2021 është ngritur Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit të Brendshëm, i cili ka miratuar Rregulloren për Hetimin Administrativ të Sinjalizuesit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në Bashkinë Delvinë dhe është mbajtur dhe regjistri i ankesave.

Bashkia vlerëson performacën e personelit nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës.

Parimi 2 - Titullari / Njësia Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se janë kryer raportimet periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB. Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë, të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari ose tek nëpunësit, të cilëve kryetari u ka deleguar përgjegjësinë, për: Hartimin dhe monitorimin e planeve vjetore dhe periodike në përputhje me objektivat strategjike, afatmesme si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit, menaxhimin/administrimin e risqeve/problemeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë (nëpërmjet identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit periodik të zbatimit të masave për zvogëlimin e risqeve), informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejojnë, si dhe

për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve. Gjithashtu janë mbajtur protokollet e takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial.

Nëpërmjet shkresës nr. 462/1prot., datë 27.02.2025 është dërguar pranë Ministrisë së Financave “Pyetëtori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”, për vitin e mëparshëm.

Nëpërmjet shkresës nr. 2748prot., datë 01.12.2023, kryetari i Bashkisë Delvinë ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut për Bashkinë Delvinë”.

Nëpërmjet shkresës nr. 214prot., datë 25.01.2024, “Për miratimin e Regjistrimit të Riskut”, kryetari i Bashkisë Delvinë ka miratuar “Regjistrin e Riskut për Bashkinë Delvinë”.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, por institucioni nuk ka në strukturë një njësi për Auditin e Brendshëm.

Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

miratuar me Urdhrin nr. 1322, datë 28.05.2020 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Delvinë”, e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, e cila është të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.

Nga auditimi konstatohet se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara.

Numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 47, datë 22.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2024 dhe Buxhetin afatmesëm për periudhën vjetore 2024-2026”, gjithsej 188 punonjës, shprehur ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr.2/1prot., datë 10.01.2024.

Struktura është miratuar me Urdhrin nr. 215prot., datë 25.01.2024 “Për miratimin e strukturës dhe klasave të punonjësve të Bashkisë Delvinë dhe institucioneve të vartësisë”.

Numri i punonjësve për vitin 2024 është 184 me kohë të plotë dhe 4 me kohë të pjesshme (gjithsej 188).

Vakancat për vitin 2024 kanë qenë 3 pozicione.

Pozicione që trajtohen me ligjin e Nëpunësit Civil 30 punonjës.

Pozicione pune të zgjedhur dhe funksionarë kabineti 10 punonjës

Pozicione që trajtohen me kod pune 148 punonjës.

Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar **15** punonjës të rinj dhe janë larguar **13** punonjës.

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se nuk ka patur delegim të detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Delvinë.

Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar **15** punonjës (nëpunës civil, kod pune dhe kontratë), pranë Bashkisë Delvinë. Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia ka hartuar një program trajnimi, ku janë përfshirë seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, por duke qenë se kanë kosto financiare trajnimit, është parë e arsyeshme që të ndiqen trajnime që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga zyra juridike dhe e burimeve njerëzore është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Për vitin 2024 janë kryer nga ASPA, ku kanë marrë pjesë nëpunës të institucionit.

Në Strukturën e Bashkisë Delvinë nuk ka Sektor për Auditin e Brendshëm dhe bashkia nuk ka bërë asnjë akt marrëveshje me ndonjë bashki tjetër për përfitimin e shërbimit të auditit të Brendshëm.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, me Urdhrin e Kryetarit nr. 685/1, datë 17.03.2023, “Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2024-2026 për bashkinë Delvinë”. Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje **14** anëtarë.

Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkuqdeset për performancën e njësisë publike.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.1 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK” a, b, c, d, pika 2.3.1; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit” dhe me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhërat e Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Anekset.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2024-2026 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 685/1, datë 17.03.2023.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nëpërmjet shkresës nr. 2748prot., datë 01.12.2023, Kryetari i Bashkisë Delvinë ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut për Bashkinë Delvinë”.

Nëpërmjet shkresës nr. 214prot., datë 25.01.2024, “Për miratimin e Regjistrimit të Riskut”, kryetari i Bashkisë Delvinë ka miratuar “Regjistrimit të Riskut për Bashkinë Delvinë”.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrimit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Delvinë ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përkrahjet e punës.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike”, pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”; “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”.

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të

mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikave, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.) Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS, AFMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.

Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësiive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të

mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

- Gjurma e auditimit.

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi” dhe me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me urdhërat e Ministrisë të Financave nr.8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Aneksat.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”.

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë.

Bashkia përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe **evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit.** Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2 dhe me Manualin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i miratuar me urdhërat e Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: “Monitorimi”.

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Bashkia Delvinë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 468prot., datë 27.02.2025 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë bashki nuk realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, pasi, nuk është ngritur Njësia e Auditit të Brendshëm, si dhe nuk është arritur të lidhet marrëveshje me bashkitë e afërta për të kryer këtë shërbim.

-Bashkia Delvinë ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1 dhe me Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhrat e Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Aneksat.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Mjedisi i kontrollit: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsisve, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Nuk janë përcaktuar objektiva konkrete, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Në Rregulloren e brendshme janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij

Menaxhimi i Riskut: Ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe regjistër risku, por procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezultoi të jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”. Në Bashkinë Delvinë, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Sektori i Tatimit Taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel, ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Është hartuar një regjistër kompleks për gjithë bashkinë, ku të identifikohen dhe të bëhet vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë. Regjistri i riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK nuk është i plotë dhe ka sjellë mosidentifikimin dhe mosvlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat

përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Delvinë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Gjithashtu, nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm një specialist IT, i cili duhet të menaxhojë dhe monitorojë gjithçka që ka lidhje me TI-në, etj.

Informimi dhe komunikimi: Sistemi i raportimit ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisive të varësisë të saj. Nuk mungojnë raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, veprohet me komunikim verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Monitorimi: Nuk mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Në Bashkinë Delvinë ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në Bashkinë Delvinë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë në përputhje me burimet dhe të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi nuk mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëmrisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. B. V., me detyrë Kryetar i Bashkisë Delvinë, znj. E. J., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe znj. E. C., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

b) Mbi funksionimin e auditit të brendshëm.

Në Strukturën e Bashkisë Delvinë nuk ka Sektor për Auditin e Brendshëm dhe bashkia nuk ka bërë asnjë akt marrëveshje me ndonjë bashki tjetër për përfitimin e shërbimit të auditit të brendshëm, pavarësisht komunikimeve me NJHAB, për rrjedhojë kjo njësi publike nuk është audituar ndër vite nga asnjë njësi e auditimit të brendshëm.

2.2. Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Për auditimin e këtij drejtimi të programit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2024 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme. debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Delvinë në mbyllje të vitit buxhetor.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “exel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet të ardhurat etj).

• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2024 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Delvinë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Bashkia Delvinë për vitin 2024 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me NIPT më vete.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Delvinë për vitin ushtrimor 2024 me shkresë përcjellëse nr.552 prot.4824, datë 10.03.2025. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Delvinë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Financës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrati banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor. Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel” dhe manual.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si, me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar për vitet 2023 dhe 2024.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës.

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilancin e vitit ushtrimor 2024.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës, Shërbime Sociale dhe Arsimit . Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se

janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e Pasqyrave Financiare, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2024”

Totali i Aktivit për vitin 2024 është në vlerën 1,312,589,754 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbrërthyer në llogari sintetike dhe analitike, si më poshtë:

Tabela nr.1: Aktivi i Bilancit 2024

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	1,312,589,754	1,198,998,450
2		I.Aktivet Afat shkurtra	244,997,025	225,804,309
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalentë te tyre	71,271,195	57,933,999
4	531	Metete monetare në Arkë		
5	512,56	Mjete monetare ne Bankë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	71,271,195	57,933,999
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	34,428,605	31,209,609
12	31	Materiale	4,316,269	1,097,273
13	32	Inventar i imët	30,112,336	30,112,336
18	37	Gjendje te pa mbitura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
20	39	Provizione perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	139,297,225	136,660,701
22	411	Klientë e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shogërore		
28	436	Sigurime Shëndetsore		
29	437,438,	Organizma të tjere shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitore të ndryshëm	93,304,193	90,254,844
33	4342	Operacione me shtetin(Të drejta)	45,993,032	46,405,857
34	45	Mardhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shpërndarë në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave të ardhshme		
42		II.Aktivet Afatgjata	1,067,592,729	973,194,141
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime		
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,021,087,449	973,194,141
48	210	Toka, T.roje, Terene	52,081,640	52,081,640
49	211	Pyje, Plantacione	4,500,000	4,500,000
50	212	Ndertesa e Konstruksione	168,047,301	159,776,179
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	780,693,711	745,072,876
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	5,405,060	5,689,537
53	215	Mjete Transporti	9,437,427	5,361,784
56	218	Inventar ekonomik	922,310	712,125
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	0	0
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	46,505,280	0
60	25	Huadhënie e Nenhuadhënie		
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	46,505,280	0

62		4.Investime		0	0
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale			
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale		0	0

Burimi: Bashkia Delvinë

A. AKTIVE AFATSHKURTRA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatshkurtra” në aktiv të bilancit paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **244,997,025** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 225,804,309 lekë.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 71,271,195 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte” të paraqitur në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 71,271,195 lekë, gjendje e cila rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2024”.

- **Gjendja e llogarisë 532 “Vlera te tjera”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 0 lekë.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **34,428,605** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 31,209,609 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej +3,218,996 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

-**Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,316,269 lekë dhënë mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,097,273 lekë, me një diferencë për vitin ushtrimor prej 3,218,996 lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2024.

-**Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët”** paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 30,112,336 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 30,112,336 lekë pa diferencë .

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 139,297,225 lekë dhënë mbyllje të vitit 2023 në vlerën 136,660,701 lekë, ku kemi shtesë duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm.

-**Gjendja e llogarisë 437, 438 “Organizma te tjerë shtetërore”** në aktiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë.

Konstatim: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 93,304,193 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 90,254,844 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ka pësuar një rritje prej 3,049,349 lekë, e cila i përket debitorëve të krijuar gjatë vitit 2024 nga taksat dhe tarifat vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar nga detyrimet e subjekteve pasive. Detyrimet e lindura nga subjektet pasive janë në vlerën 34,230,884 lekë të analizuara subjekte të Biznesit të vogël gjithsej 167 (njëqindgjashetëdhjeteshtatë) me vlerë 7,443,206 lekë dhe nga 2(dy) subjekte të biznesit të madh me vlerë 26,787,678 lekë.

Tabela nr.2: Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi në zëra	Gjendje 31.12.2023	Shtuar gjate vitit ushtrimo	Pakesuar gjate viti ushtrimor	Gjendje 31.12.2024
1	Biznesi I Vogël sipas listës	10,017,610	2,247,011	2,163,823	10,100,798
2	K.L.Sh-ja sipas listës	73,086			73,086
3	Çerdhja sipas listës	211,225	252,750	235,250	228,725
4	LJ	3,412		3,412	-

5	N.B	157,360			157,360
6	M.M	28,200			28,200
7	Xh.B	500			500
8	E.Sh	11,000			11,000
9	D.S	1,865			1,865
10	Sh. M	289			289
11	A.S	500			500
12	A.T	5,865			5,865
13	B.K	917			917
14	P.D	25,126			25,126
15	G.N	201,600			201,600
16	P.M	648			648
17	SHPK "K..."	838,567			838,567
18	SHPK "S..."	220,790			220,790
19	"D... G.. C..."	56,379	91,680	91,680	56,379
20	Njesia Administrative Vergo				-
	- pagat e vjedhura 1998	577,333			577,333
	- qera toke viti 2017	212,888			212,888
	- qera toke viti 2018	200,648			200,648
	- qera toke debitore nga K.L.Sh-ja 2016	219,306			219,306
	-debitoret e K.L.Sh,keshilltaret	530,145			530,145
	- qera toke viti 2019	234,923			234,923
	-debit.e K.L.Sh,tok/bujq,kamat vonesa	1,706,449			1,706,449
	- qera toke viti 2020	576,226			576,226
	- qera toke viti 2022	947,911			947,911
	- qera toke viti 2021	658,681			658,681
	- qera toke viti 2023	1,036,824			1,036,824
	- qera toke viti 2024		1,240,171	520,200	719,971
21	"J... K... "SHPK	1,470,030			1,470,030
22	"S... O...@G.. A..."SHPK	20,274,078			20,274,078
23	"Th... E... A..."SHPK	6,513,600			6,513,600
24	Debitoret e K.L.SH-se Zyra e taksave	1,738,521			1,738,521
25	Debitoret e K.L.SH-se Zyra e tokes qera per 99 vite	208,916			208,916
26	Debitoret e Z/tokes ,qera per 99 vite,Bashkia	120,858	635,114	413,500	342,472
27	Debitoret e K.L.SH-se Gjobat Polici bashkiake	48,000			48,000
28	Debitoret e K.L.SH-se Keshilltaret e Bashkise	1,176,950			1,176,950
29	Debitoret e B/Madh taksat vendore	3,321,845	4,947,208	5,251,183	3,017,870
30	S. I. qera objekti	331,080			331,080
31	Institucionet, Sh.a	460,000	898,278	838,278	520,000
32	"G... C..." Sh.pk	2,310,600			2,310,600
33	Debitoret e taksas se tokes Delvina	21,689,215	3,945,858	3,332,686	22,302,387
34	Debitoret e taksas se tokes Nj,Ad.Vergo viti 2019	2,553,759			2,553,759
35	E.B	50,000			50,000
36	Debitoret e taksas se tokes Nj,Ad.Vergo viti 2020	2,225,153			2,225,153
37	Debitoret e taksas se tokes Nj,Ad.Vergo viti 2021	1,319,000			1,319,000
38	Debitoret e taksas se tokes Nj,Ad.Vergo viti 2022	2,493,566	-		2,493,566
39	A.M	50,000			50,000
40	B.K	50,000			50,000
41	R.S	50,000			50,000
42	Debitoret e kopshtit te femijeve	135,040	975,360	936,440	173,960
43	Debitoret e taksas se tokes Nj,Ad.Vergo viti 2023	2,408,360			2,408,360
44	Debitoret e taksas se tokes Nj,Ad.Vergo viti 2024		2,919,360	1,316,989	1,602,371
45	Sovjete Mero	500,000			500,000
	Shuma	90,254,844	18,152,790	15,103,441	93,304,193

Burimi: Bashkia Delvinë

Analiza e debitorëve për disa taksa e tarifa vendore paraqitet më poshtë:

▪ Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa vendore me datë 31.12.2024.

Nga përpunimi i të dhënave nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifatat vendore si më poshtë:

Bashkia	Emërtimi	Vlera totale e debitorëve (progresive ne fund 2023)	Shtesa e debitorëve te vitit raportues	Pakesime gjate vitit 2024	Debi e krijuar gjate vitit 2024, pra shtesa minus pakesime	Vlera totale e debitorëve (progresive ne fund 2024)	Vlera e kontabilizuar e debitorëve ne PF ne mbyllje te vitit 2024	Vlera e kontabilizuar e debitorëve ne PF ne mbyllje te vitit 2024 persa i takon vetëm vitit 2024	Diferenca e pa kontabilizuar
		a	b	c	d=b-c	e=a+d	f	g	h=e-f
Llog.468	Debitorë të ndryshëm	90,254,844	18,152,790	15,103,441	3,049,349	93,304,193	93,304,193	4,079,669	0
	Nga këto:								
PF	Debitorë nga KLSH-ja	31,994,176				31,994,176	31,994,176	0	0
PF	Debitorë nga tatim-taksa	58,260,668	18,152,790	15,103,441	3,049,349	61,310,017	61,310,017	4,079,669	0
Sektori i	Debitorë nga tatim-taksa	13,339,455	11,346,769	11,346,769	-220,787	13,118,668		13,118,668	0
Tatim	a. Biznesi Madh/vogël	13,339,455	7,194,219	7,415,006	-220,787	13,118,668		13,118,668	0
Taksa	b. Familjarë	0	4,152,550	4,152,550	0	0	4,152,550	0	0

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifatat vendore, ku në **fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 90,254,844 lekë**, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën **18,152,790 lekë**, janë kryer arkëtime në shumën **15,103,441 lekë**. Detyrimet progresive **në fund të vitit 2024 janë në shumën 93,304,193 lekë, pra me rritje** e cila përbëhet nga detyrimet debitorë nga biznesit i madh dhe i vogël në shumën 13,118,668 lekë.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Delvinë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenet 6 dhe 9/pika 1.3.

Nga Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Delvinë për vjeljen e detyrimeve janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësim detyrimin dhe vendosjen e një gjobe dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”.

▪ Debitorët nga mos arkëtimi taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Bashkia Delvinë	Realizimi 2023	Plani 2024 (detyrimeve sipas kontratave të lidhura)	Realizimi i 2024 (arkëtim)	Diferenca Plan-Fakt 2024	Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Debi në fund 2023	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Diferenca mes vlerës se kontabilizuar dhe debise ne fakt
							Krijuar 2024	Vlera pogresive		
TNI nga legalizimet	604,857	1,071,724	978,910	-92,814	978,910	0	92,814	-		

Konkluzion: Nga auditimi dhe referuar të dhënave të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave konstatohet se:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet reja është realizuar 978,9 mijë lekë nga 1,072 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 91%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 604,8 mijë lekë ose 374 mije leke me pak viti 2024. Mos arkëtimi i detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në kundërshtim VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3 dhe me paketën fiskale.

- Debitorët nga mos arkëtimi i tarifës së qirasë , si detyrim kontraktor nga dhënia me qira të parcelave

Të ardhurat nga tarifa e qerave janë realizuar në shumën 1,025 mijë lekë, nga shuma prej 1,966 mijë lekë e planifikuar, ose në masën 52%, ndërsa realizimi në fakt në vitin 2023 ka qenë 1,271 mijë lekë, pra në planifikimi janë marrë në konsideratë kontratat afatgjatë të lidhura, por nuk janë marrë në konsideratë kontratat sezonale.

Planifikimi, realizimi, detyrimet debitore dhe kontabilizimi i tarifës së qirasë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Delvinë	Realizimi 2023	Plani 2024 (detyrimeve sipas kontratave të lidhura)	Realizimi 2024 (arkëtim)	Diferenca Plan-Fakt 2024	Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Debi në fund 2023	Debia ne fund 2024		Vlera e Kontabilizuar ne fund 2024	Diferenca mes vlerës se kontabilizuar dhe debise ne fakt
							Krijuar 2024	Vlera pogrësive		
Tarifa per qeraja	1,271,910	1,966,974	1,025,380	-,276,405	941,594	0	0	0	0	0

-**Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në shumën 45,993,032 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2024, që trashëgohen në vitin 2024. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 3,234,989 lekë, llog.42“Detyrime ndaj personelit” për vlerën 11,070,078 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,228,483 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,352,144 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 353,904 lekë dhe vlerën prej 26,753,434 lekë të llog.467“Kreditorë të ndryshëm” të planifikuar për likuidim në vitin 2025. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërpartit në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjatë**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **1,067,592,729** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 973,194,141 lekë, ku diferenca përfaqëson shtesën e asetëve dhe vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,089,524,652 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,193,521,659 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjatë jo materiale”

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në si në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë. Në mënyrë të detajuar gjendja e kësaj llogarie paraqitet në Aneks:

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2023 dhe 2024.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivët afatgjatë materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **1,021,087,449** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 973,194,141 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,193,521,659 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,089,524,652 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto me vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 52,081,640 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 52,081,640 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2024 është 52,081,640 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 52,081,640 lekë pasi nuk ka shtesa gjatë vitit 2024. Kjo gjendje paraqitet e analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3 : Inventari kontabël i llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” më datë 31.12.2024

Nr	Përshkrimi	Gjendje ne fund te ushtrimit 2023	Shtesa gjatë 2024	Pakësim e gjatë 2024	Gjendje ne fund te ushtrimit 2024
1	Njësia Administrative Delvinë	51,936,640			51,936,640
	Varrezat publike	5,237,322			5,237,322
	Varrezat e qytetit	260,760			260,760
	Rrethimi I Zyrave te Bashkisë	514,198			514,198
	Truall Ish Brigada Këmbësorisë Delvine	45,911,360			45,911,360
2	Njësia Administrative Vergo	158,000			158,000
	Shuma	52,081,640			52,081,640

Burimi: Bashkia Delvinë

Konstatim: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në shumën prej 4,500,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,500,000 lekë. Ndërsa

sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,500,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 4,500,000 lekë. Bashkia Delvinë ka në administrim një fond pyjor dhe kullësor prej 12,852.16 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar. Me VKM nr. 59, datë 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore”, VKM nr. 60, 26.01.2022 “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV) si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”, kufijtë e zonave të mbrojtura kanë ndryshuar me shtim dhe reduktim të disa sipërfaqeve. Aktualisht lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është 391 prona të transferuara. Në Zyrën Vendore të ASHK Sarandë rezultojnë se janë çelur kartela të pasurive të paluajtshme për 416 pasuri pyje dhe kullota, për të cilat Bashkia Delvinë ka aplikuar vetëm për 9 (nëntë) pasuri. Nuk ka aplikuar për certifikatë pasurie gjatë vitit 2024, për arsye mungesë fondesh të planifikuara për këtë qëllim. Në buxhetin e vitit 2025 është planifikuar një shumë prej 200,000 lekë për aplikim për certifikatë pasurie.

-Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 168,047,301 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 159,776,179 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 235,286,754 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 219,007,862 lekë. Gjatë vitit 2024 janë pakësuar aktive për shkak të amortizimit në vlerën 8,007,770 lekë dhe janë shtuar aktive në vlerën 16,278,892 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet për vitin 2024, sipas inventarit në vlerë bruto paraqiten në Aneks.

Tabela nr.4 : Inventari kontabël i llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” më datë 31.12.2024

Nr	Emertimi i Aktiveve (llogaria 212)	Gjendja me 31.12.2023	Shtesa viti 2024	Pakesime viti 2024	Gjendja me 31.12.2024
1	Ambulanca Tip A2	996,700			996,700
2	Cerdhja e femijeve	39,206,695			39,206,695
3	Qender shëndetsore Stjar	992,208			992,208
4	Zyrat e bashkise	11,323,669			11,323,669
5	Ndertesa te Ish Brigada e Kembesorise Delvine	2,537,000			2,537,000
6	Shkolla e mesme	1,965,100			1,965,100
7	Thertorja	2,337,680			2,337,680
8	Muzeu Delvine	10,076,055			10,076,055
9	Ambulanca Vane	1,044,850			1,044,850
10	Ambulanca Lefterohor	986,498			986,498
11	Shtepia e Kultures	5,536,877			5,536,877
12	Poliklinika Delvine kati I dyte	1,984,413			1,984,413
13	Shkolla CU Vllahat	1,980,593			1,980,593
14	Shkolla "K.Çavo"	19,845,270			19,845,270
15	Rikonstruk.fasadeve ne qender qytetit	8,543,273			8,543,273
16	Shkolla CU+Kopesht Bamatat	16,137,668			16,137,668
17	Lulishte qender qytetit	756,840			756,840
18	Rikonstrukcion I kopshtit Papuçi	183,375			183,375
19	Gurri I Pavaresise	480,000			480,000
20	Rrethim I Varezave Fshati Blerimas	389,558			389,558
21	Shkolla Blerimas	1,110,733			1,110,733
22	Shkolla Blerimas + Kopshti (Ndertesa e re)	17,056,225			17,056,225
23	Shkolla 9-Vjecare "Seit Gaci"Stjar	2,789,088			2,789,088
24	Shkolla 9-Vjecare "Xhelal Berberi"	441,520			441,520
25	Shkolla 9-Vjecare Bajkaj	2,457,160			2,457,160
26	Godina e Zjarefikeses Delvine	1,450,000			1,450,000
27	Ndertesa stacione ujitjeje	1,307,656			1,307,656
28	Njesia Administrative Vergo	35,701,193			35,701,193
29	Peme dekorative Njesia Administrative Vergo	119,520			119,520
30	Mure mbajtese Lagjia Lejla Malo	710,880			710,880

31	Kopshti i fshatit Bajkaj	1,485,922		1,485,922
32	Muzeu i fshatit Senicë	515,275	379,228	894,503
33	Argjinatura e lumit Vris Delvinë	675,474		675,474
34	Banesa të komuniteteve të varfëra e në nevojë	23,049,868	15,899,664	38,949,532
35	Ambulanca e fshatit Palavli	969,810		969,810
36	Qendra Shendetesore fshatit Rusan	1,146,362		1,146,362
37	Qendra Shendetesore fshatit Sopot	716,854		716,854
	Shuma	219,007,862	16,278,892	235,286,754

Burimi: Bashkia Delvinë

-Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 780,693,711 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në 745,072,876 lekë. Gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 780,693,711 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 745,072,876 lekë. Gjatë vitit 2024 janë bërë shtesat në vlerën 35,620,835 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet për vitin 2024 paraqiten në Aneks.

Tabela nr.5: Inventari kontabël i llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” më datë 31.12.2024

Nr	Emërtimi i aktiveve Llogaria 213	Gjendja me 31.12.2023	Shtesa gjatë 2024	Pakësime gjate 2024	Gjendja me 31.12.2024
1	Rruge te brendshme të qytetit Delvine	8,279,442	1,376,524		9,654,966
2	Rjeti I Ndricimit te qytetit	14,438,447			59,683,841
3	Asfaltimi I rrugeve dhe Q.Qytetit	11,729,104			9,923,427
4	Rruga "B.Shena"	5,120,000			11,539,247
5	Rruga Rep.Usharak	3,044,648			13,386,081
6	Rruga Rusan	40,345,146			31,925,601
7	Rruga "V.Kallapodhi"	2,375,820			9,080,765
8	Rruga te brendshme Vllahat	10,985,499			32,183,191
9	Rruga "J.Xhavara"	5,499,341			11,713,323
10	Rruga Fushe Vërrë-Kalasë dhe Blerimas-Finiq	36,386,992	4,000,000		40,386,992
11	Rruga Vane	39,574,636			9,113,930
12	Rruga Ura e Shk."K.Cavo"	338,366			7,817,001
13	Rruga Xhermahall	3,997,866			30,688,877
14	Rruga Xhami-NPN	4,763,607			26,594,183
15	Rruga Stjar	737,600			23,190,279
16	Rruga " 9 Tetori"	12,936,849			43,962,342
17	Rruga Vare	485,060			12,136,287
18	Ura e rruges "L.Malo"	484,500			7,557,607
19	Rruga "S.Ballaci"	2,973,108	1,981,000		4,954,108
20	Rruga e Zejtareve	4,961,520			45,419,997
21	Rruga e Kishes	1,889,400			17,544,794
22	Rruga e shk."Xh.Berberi"	1,710,939			13,957,476
23	Rruge ,Trotuare te qytetit	8,234,514			20,689,031
24	Rruga "N.Abazi"	24,666,347			17,598,034
25	Rruga Kasapaj	4,978,010			60,193,932
26	Rruga "H.Musta"Bamatat	429,750			1,960,526
27	Rruga "V.Kaplani"Bamatat	278,500			7,129,401
28	Rruga Bamatat	491,094			4,802,879
29	Blloku Nr.2 Delvine	32,735,130			8,293,468
30	Rruge te qytetit	6,018,870			12,742,962
31	Rruga Varrezave te Deshmoreve	152,820			5,400,933
32	Rrethim I varrezave Stjar	981,346			5,195,874
33	Rruge te brendshme fshatrat e Nj.Admin. Vergo	1,788,600			2,847,585
34	Murri rrethues I Shk.mesme	459,924			802,270
35	Rruga varrezave publike Lefterohor	500,000			3,643,825
36	Rruga Kakodhiq-Lefterohor-Sopot	6,179,737			1,567,807
37	Rruga "Mane Boçi"	4,153,470			33,861,194
38	Rruga "Qemal Stafa"	8,151,927			10,919,544
39	Rruga "H.Shereti"	25,817,060			9,990,919
40	Rruga "R.Demo"	4,650,000			2,958,213
41	Rjeti I Ujesjellesit Stjar- Vllahat	150,000			17,053,789
42	Rruga e Varrazave Publike	18,258,750			26,628,428
43	Rruga Qender-Kopshti Femijeve Stjar	4,267,667			6,267,960
44	Rruga Qender-Burimi I Baburajve Rusan	6,937,500			1,954,320
45	Rjeti I ndricimit ish-Shk.Bujgesore-Lagja Rome	393,080			30,744,413
46	Rjeti I ndricimit rruges "DH.Konduri" Delvine	463,800			37,839,635
47	Murre te kalase	439,380			18,425,268
48	Rruga "K.Arapi"Bamatat	294,150			27,300,152
49	Ura vane	727,300	13,386,493		14,113,793
50	Rruga "PetrËt Isufi" Bamatat	736,800			22,346,175
51	Rjet kabllor interneti	226,160			11,142,006
52	Ndricim publik Fshati Blerimas	595,056			9,015,732
53	Rruga Blerimas Finiq	5,965,504			1,778,520
54	Trotuari rruga hyrese e qytetit Delvine	6,876,104			10,859,323
55	Sheshi Qender Delvine	133,082,727			12,440,686
56	Rruga N.Zenuni	748,314			12,323,327

57	Rezervuar	6,393,514		6,095,971
58	Kanal ujtes	90,165,927		21,777,841
59	Kanal kullues	1,317,000		20,417,029
60	Njesia Administrative Vergo	4,792,789		9,380,959
61	Rruga e fshatit bajkaj	3,023,016		26,613,722
62	Rruga e fshatit Stjar	3,382,812		6,683,906
63	Rruga e Varrezave Fushe-Veri	2,279,626		8,209,384
64	Rruga Gjovrak Kopacez	1,184,640		87,886,147
65	Rruga Kallapodhajve Rusan	639,600		28,247,789
66	Rruga e Raxhajve Vllahat	373,200		25,281,843
67	Rruga Delvine -Lefterohor	830,400		67,487,665
68	Rruga te brendshme Rusan	2,841,680		40,960,013
69	Rruga e Varrezave Vergo	503,592		1,051,272
70	Kanali K.K.5 Bajkaj	22,673,989		5,759,513
71	Rruge te brendshme fshati Blerimas	1,566,528		7,988,315
72	Rruge te brendshme fshati Stjar	612,504		3,588,160
73	Varrezat e deshmoreve	2,431,650		9,272,322
74	Rruga "Jasin Kseno" Lagja "Lejla Malo"	2,147,152		5,103,990
75	Rruga "Fejzo Demaj" Lagja "Lejla Malo"	2,614,800		7,886,511
76	Sheshi Qender fshatit Tatzat	1,495,500		13,001,437
77	Rruga hyrese fshatit Vergo	2,588,761		6,603,134
78	Rruge te brendshme fshati Kalase	2,369,252		15,271,110
79	Rruga Vane	175,200		111,611,614
80	Sistemim rruge te brendshme ne Fshatin Rusan	667,392		91,814,477
81	Rruga Bajkaj -Kopacez - Isak	7,391,076	15,600	7,406,676
82	Rruga Tatzat -Kalase-Senicë	4,410,600		6,956,280
83	Rruga Fushe Verri - Vergo-Palavli	3,000,000	1,526,874	4,526,874
84	Rruga Rusan-Vllahat	7,296,390	417,906	7,714,296
85	Rruga Delvine -Lefterohor-Sopot	4,336,237		1,231,436
86	Rruga Shijan -Stjar-Bamatat	10,065,695	2,299,468	12,365,163
87	Rruga e Manastirit Kakodhiq	1,471,680		5,743,642
88	Rrejtii I kanaleve ujitese	9,235,721		68,687,708
89	Fusha e futbollit	10,281,652		41,904,655
90	Rruge te brendshme ne Lagjen"L.Malo" Delvine	4,544,500	616,970	5161,470
91	Shesh pushimi I rruges "Javer Malo" Delvine	1,409,760		7,821,230
92	KUZ prane shkolles së mesme S.Delvina"	671,760		205,790,215
93	Kanali Trushes	0	10,000,000	10,000,000
	Shuma	745,072,876	35,620,835	780,693,711

Burimi: Bashkia Delvinë

-Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,405,060 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,689,537 lekë. Ndërsa gjendja sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2024 ne vlerën 5,405,060 leke dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën lekë ku 5,689,537 është pakësuar gjatë vitit 2024 nga amortizimi vjetor .Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Vlefte
1	Instalime ne rrejtii e ndricimit rruges "V.Kallapodhi"	1,598,640
2	Instalime ne rrejtii e ndricimit te fshatrave	4,834,908
3	Instalimi I sinjalizuesve te zjarrit	280,000
4	Makine korrese bari	75,000
5	Makine korrese bari	50,000
6	Linje tensioni I ulet prane Shkolles "K.Çavo"Delvine	98,712
7	Instalim sherbimi logjistik ne shk.S.Delvina"	115,674
8	Linja Elektrike Fshati Blerimas	399,830
9	Aparat frymemarje Interspiro spiromatik 90 me aparat per mushkri MAS -N200	35,000
10	Pajisje hidraulike shpetimi	105,000
11	Agregat per energji elektrike 5 KVA	175,000
12	Makineri pajisje stacione pompimi	180,406
13	Kazan Metalik me kapak	448,560
14	Njesia Administrative Vergo	80,974
15	Aparat saldimi elrtronik 200Ë	26,400
16	Fresibel 2600ë,2300MM,11000RPM 2 cop	30,000
17	Trapan dore me bateri 18v,1.5 A 1500RPM 2 cop	21,600
18	Trapan dore elektrik 550Ë (220-230)V cop 2(dy)	24,000
19	Betoniere me motor fuqi 6.5 hp kapaciteti 190 l	80,400
20	Matrapik godites dhe shpues 705 Ë metal 13mm/goditje	39,600
21	Kosha mbeturinash 1100 lt	2,187,528
22	Kosha mbeturinash 1100 lt	726,918
23	Motokorrese	24,240
24	Motosharre	15,720
25	Stola me krahe gize	240,000
26	Kosha mbeturinash 10kg	600,000
	Shuma	12,494,110

Burimi: Bashkia Delvinë

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 9,437,427 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,361,784 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet si në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 35,431,117 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 36,436,354 lekë, gjë që tregon se ka shtesa në vlerën 5,148,000 lekë dhe pakësim për mjetet e dëmtuara në vlerën 6,153,237 lekë në vitin 2024. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2023 dhe 2024 paraqiten në Aneks:

Tabela nr.6 : Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2023,31.12.2024

Nr	Emërtimi I aktiveve	Gjendja me 31.12.2023	Shtesa gjatë 2024	Pakësime gjate 2024	Gjendja me 31.12.2024
1	Makina e pastrimit	803,025		803,025	0
2	Makina e pastrimit	196,212		196,212	0
3	Autoveture e administrates Benz Targa DI 3080 A	1,475,000		1,475,000	0
4	Makina tip "Xhip Hundaj" marka Galloper	1,480,000		1,480,000	0
5	Mjet Benc	800,000			800,000
6	Autoveture tip "Ford" Targa AA 253 IU	698,600			698,600
7	Makina teknologjike e pastrimit Targa AA 178 NR	1,428,000			1,428,000
8	Automjeti "Stajer" PMNZSH	1,000,000			1,000,000
9	Automjeti "Marta Internacional"	700,000		700,000	0
10	Volsvagen PMNZSH	1,471,086			1,471,086
11	Xhip Lanrover	1,248,800			1,248,800
12	Xhip Foristradë	1,499,000		1,499,000	0
13	Skrepi Targa AI-MT 63	2,614,500			2,614,500
14	Skrepi I Bordit te Kullimit	16,347,131			16,347,131
15	Automjet tip DAMLER targa AA8821N	1,000,000			1,000,000
16	Automjet Tip Hyundai Terrecan	3,675,000			3,675,000
17	Kamion Zjarrefikese		5,148,000		5,148,000
	Shuma	36,436,354	5,148,000	6,153,237	35,431,117

Burimi: Bashkia Delvinë

- **Gjendja e llogarisë 218** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 922,310 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 712,125 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 20,375,810 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,931,810 lekë. Shtesa ne vlerën 444,000 lekë për gjatë vitit 2024.

Tabela nr.7: Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2024 paraqiten në Formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Refer	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historik	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
Llog		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/O MATERIALE										
202	Studime dhe kerkime										
21-	II. AAGJ/ MATERIALE	1,089,524,652	116,330,511	973,194,141	110,150,244	15,751,656	6,153,237	6,153,237	1,193,521,659	125,928,930	1,067,592,729
210	Toka,troje,Terene	52,081,640	0	52,081,640	0	0			52,081,640	0	52,081,640
211	Pyje,Kullota Plantacion	4,500,000	0	4,500,000					4,500,000	0	4,500,000
212	Ndertime e Konstruksion	219,007,862	59,231,683	159,776,179	16,278,892	8,007,770			235,286,754	67,239,453	168,047,301
213	Rruge,rrjete,vepra ujor	745,072,876	0	745,072,876	35,620,835	0			780,693,711	0	780,693,711
214	In.tekn,makipais,veglpu	12,494,110	6,804,573	5,689,537	0	284,477			12,494,110	7,089,050	5,405,060
215	Mjete transporti	36,436,354	31,074,570	5,361,784	5,148,000	1,072,357	6,153,237	6,153,237	35,431,117	25,993,690	9,437,427
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0			0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0			0	0	0
218	Inventar ekonomik	19,931,810	19,219,685	712,125	444,000	233,815			20,375,810	19,453,500	922,310
24	A.Q.T te demtuara	0	0	0	6,153,237	6,153,237			6,153,237	6,153,237	0
26	Pjesemarje ne kapitalin e vet	0	0	0	46,505,280				46,505,280	0	46,505,280

	TOTALI(I+II)	1,089,524,65 2	116,330,51 1	973,194,14 1	110,150,24 4	15,751,65 6	6,153,23 7	6,153,237	1,193,521,65 9	125,928,93 0	1,067,592,72 9
--	--------------	-------------------	-----------------	-----------------	-----------------	----------------	---------------	-----------	-------------------	-----------------	-------------------

Burimi: Bashkia Delvinë

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 9,598,419 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

Inventarizimi i aktiveve

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 dhe 2024 për Bashkinë Delvinë dhe Njësinë Administrative Vergo në varësi.

Për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2024 kanë dalë urdhri i titullarit me nr. 2977prot., datë 31.12.2024 “Për ngritjen e komisionit për inventarizimin të materialeve dhe aktiveve të trupëzuara për vitin 2024”. Në bazë të këtij urdhri janë përcaktuar 5 (pesë) komisione të inventarizimit sipas objekteve ku do kryhet inventarizimi. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara krahasuar dhe me gjendjen kontabël sipas llogarive si për Aparatin e Bashkisë, Kulturën dhe Q.K.F-në, për Njësinë Administrative Vergo dhe shkollat e fshatit, shkollat, kopshtet e qytetit dhe çerdhja, Sektori P.M.N.Z.SH. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2024 dhe rezultojnë pa diferenca. Është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Nga këto komisione janë bërë propozimet për aktivet që nuk kanë më vlerë përdorimi. Prosesi i inventarizimit vazhdon për kryerjen e procedurave të nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të propozuara. Për vitin 2024 nuk janë kryer procedurat e nxjerrjes së materialeve dhe aktiveve afatgjata jashtë përdorimit.

➤ Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror, certifikimi, vlerësimi dhe kontabilizimi i tyre.

Bashkisë Delvinë përveç pasurive të paluajtshme (aktive) të vlerësuara të paraqitura në PF i janë transferuar listat përfundimtare të inventarëve me VKM përkatëse të gjitha pasuritë e paluajtshme që shtrihen në territorin nën juridiksionin e bashkisë, ku numri dhe statusi i tyre sipas njësive administrative paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Delvinë	Njësia Administrative Vergo	VKM nr. ...date....	Sasi	Certifikuar	Inventarizuar	Vlerësuar	Kontabilizuar	Prona të zaptuara	Prona në proces legalizimi	te tjera që mund të shtohen sipas llojit
1		Nr.453.dt.09.07.2004	27	27	27	proces	po	0	0	0
2		Nr.1265.dt.16.12.2009	283	6	283	proces	jo	0	0	0
	3	Nr.433.dt.08.06.2016 ndryshuar me Nr.684.dt.02.09.2020	416	9	416	proces	po	0	0	0

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e ndjekura për hipotekimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të listave përfundimtare të formularëve të inventarit të transferuara me VKM nga pushteti qendror u konstatua se, Bashkisë Delvinë i janë transferuar në përdorim/pronësi 310 asete dhe 416 pyje e kullota, me sipërfaqe 12,852.16 ha, nga të cilat ka të regjistruara dhe pajisur me certifikate vetëm 42 asete, rrjedhimisht dhe të inventarizuara. Për pjesën tjetër të pasurive të pa luajtshme dhe parcelat nga fondi pyjor/kullor nuk është kryer përditësimi i inventarit dhe janë marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre në DVASHK Sarandë. Gjithashtu ndodhet në procesin e vlerësimit të pasurive të paluajtshme si ato të certifikuara dhe ato të pa certifikuara.

Në pasqyrat financiare aktivet të evidentuara në llogaritë: llog.210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 52,081,640 lekë, llogaria 211 “Pyje, kullota plantacione” në vlerën 4,500,000 lekë dhe llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 168,047,301 lekë, të cilat janë AAGJM (pasuri) që kanë mbetur pronë shtet të trashëguara nëpërmjet PF të ish-institucioneve që para viteve 1990 bashkisë dhe ish-komunave. Bashkia Delvinë për vitin 2024 nuk ka kryer asnjë veprim për hipotekimin e këtyre AAGJM në pronësi të saj, por për vitin 2025 ka parashikuar një fond prej 200,000 lekë për shpenzime hipotekore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-4, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 4, Kreu III, pika 35.

Tabela nr.8: Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Në lekë

Nr.Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2024	Ushtrimi Paraardhës 2023
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	151,460,933	147,634,870
66		I. Pasivet Afat shkurtra	151,460,933	147,634,870
67		1. Llogari te Pagueshme	151,460,933	147,634,870
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	3,234,989	622,972
69	42	Detyrime ndaj personelit	11,070,078	8,308,583
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,128,483	753,663
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	3,352,144	2,435,719
76	436	Sigurime Shëndetësore	353,904	331,101
77	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
78	44	Institucione te tjera publike	0	1,413,000
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjëve ekonomike		
80	464	Det. për tu paguar për bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	12,163,708	10,974,169
82	467	Kreditore te ndryshëm	26,753,434	33,953,817
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	93,304,193	90,254,844
84	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse	0	0
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit		
91		II. Pasivet Afat Gjata		0
92	Klase 4	Llogari te pagueshme		
93	16,17,18	Huatë Afat gjata		
94		Provizjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,161,128,821	1,051,363,580
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,161,128,821	1,013,532,892
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,055,516,054	980,446,102
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	59,107,487	33,086,790
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata		
107	Klasa 5	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	46,505,280	0
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,312,589,754	1,198,998,450

Burimi: Bashkia Delvinë

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën **151,460,933** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

-Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 3,234,989 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 622,972 lekë, vlerë e cila ka ndryshuar me faturat e muajit dhjetor.

Tabela nr.9: Analiza e gjendjes së llog.401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Nr.	Subjekti	Mbetje 31.12.2023	Pakësuar	Shtesat 31.12.2024	Pakësuar	Gjendja 31.12.2024
1	I.D	0	0	204,000	204,000	0
2	“K...” shpk	0	0	3,234,989	0	3,234,989
3	“A...” shpk	35,332	35,332	0	0	0
4	“B... S...” shpk	587,640	587,640	587,640	587,640	0
5	E.L			1,678,800	1,678,800	0
	Shuma	622,972	622,972	5,705,429	2,470,440	3,234,989

Burimi: Përpunuar nga grupi i KLSH-së.

- Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 11,070,078 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2024 për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2025.

-Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën kontabël 1,228,483 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2024 për detyrimet tatimit mbi pagën në shumën 893,849 lekë që do të paguhen në janar të vitit 2025, dhe tatim i mbajtur ne burim 334,634 lekë.

-Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 3,352,144 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

-Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” në fund të vitit 2024 është në vlerën kontabël 353,904 lekë.

Konstatim: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuarra për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 12,163,708 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Delvinë.

Gjatë vitit 2024 shuma e likuiduar është 774,770 lekë. Kjo shumë është e pa konsiderueshme në raport me gjendjen e akumuluar të kësaj llogarie. Rezulton se janë plotësuar afatet kontraktuale për likuidimin e vlerës së garancisë në shumën 1,320,467 lekë për 11 (njëmbëdhjetë) subjekte, nga ditari i marrëdhënieve me Thesarin, nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve, janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve duke u njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse sipas aneksit nr. 5 analiza e llogaris 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. Pas njoftimit të subjekteve me afatet kontraktuale të plotësuar është likuiduar vetëm shuma prej 498,232 lekë sipas dokumentacionit të paraqitur pranë institucionit nga subjektet përfituese.

-Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 26,753,434 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 33,953,817 lekë me një diferencë në ulje prej 7,200,383 lekë. Ulja e kësaj vlere tregon dhe uljen e kreditorëve të ndryshëm. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në Aneks:

Analiza e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”

Nr.	Subjekti	Mbetje 31.12.2023	Pakësuar nga viti 2023	Gjendja nga viti 2023 dhe shesat 2024	Pakësuar	Gjendja 31.12.2024
1	B... L... shpk	-	-	3.293.125	2.472.310	820.815
2	Keshilli I Qarkut Vlore	132.119	132.119	332.246	312.451	19.795
3	A... sha	1.600	1.600	-	-	-
4	P... D...	-	-	247.511	247.511	-
5	O... T...	13.720	13.720	180.130	143.337	36.793
6	U... K... sha	69.182	69.182	1.024.619	946.017	78.602
7	Keshilltare +kryepleq	238.255	238.255	4.699.174	3.722.014	977.160
8	Agjent tatimor S... P...	4.447	4.447	0	0	0
9	P... sha Agjent tatimor	11.563	0	20.346	0	20.346
10	M... K... agjent tatimor	7.213	7.213	6.573	0	6.573
11	U... sha D...	0	0	261.567	0	261.567
12	Shpk J... C...	4.633.614	1.981.000	2.652.614	0	2.652.614
13	E... B...	713.502	0	713.502	0	713.502
14	A... B...	50.400	50.400	200.640	200.640	0
15	M.K	533.136	0	533.136	0	533.136
16	L... C... shpk	4.701.884	2.299.468	2.402.416	0	2.402.416
17	G... C... shpk	67.200	0	67.200	0	67.200
18	C... P...	0	0	7.920.000	6.695.021	1.224.979
19	H... SHPK	153.245	0	153.245	0	153.245
20	L... shpk	4.317.502	4.317.502	0	0	0
21	I... shpk	15.600	15.600	0	0	0
22	A.K	27.333	0	27.333	0	27.333
23	O...	4.480.848	851.069	10.031.580	3.287.525	6.744.055
24	Ekspert te jashtem	208.250	208.250	0	0	0
25	D...S	6.114.400	0	0	0	6.114.400
26	B...P...	134.950	0	134.950	0	134.950
27	A...E...	22.200	0	266.419	0	266.419
28	A... C...	7.175.204	4.000.000	3.175.204	0	3.175.204
29	K... shpk	4.450	0	4.450	0	4.450
30	M.B	98.400	98.400	0	0	0
31	A.C	23.600	23.600	0	0	0
32	D...C... S...	0	0	317.880	0	317.880
	TOTALI	33.953.817	14.311.829	44.780.260	18.026.826	26.753.434

Burimi: Përpunuar nga grupi i KLSH-së.

- Raportimi i detyrimeve në Ministrinë e Financës është bërë me shkresën nr. 387prot., datë 17.02.2025 me lëndë “Dërgohen formatet e vetëvlerësimit financiar Janar-Dhjetor 2024”, sipas udhëzimit nr. 35, datë 29.12.2023, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

Detyrimet total në fund të vitit 2023	Lloji i detyrimit										Diferenca (vlera totale e detyrime-ve vlera e kontabilit-zuar)
	P a g a	Detyrimet për likuidimin e faturave tatimore për shpenzime korren-te (maltra,shërb i-me e mirëmbajtje)	Detyrimet për likuidimin e faturave tatimore për investime	Detyrimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore	Shpe nzim e përm baru e- sesi	Detyri met për likuidi min e huave afatgj ata	Energji	Investi me	Totali i detyrimeve në fund të vitit 2024	Shtesa gjatë vitit 2024	
32.753.302	0	3.049.850	17.596.862	1.246.638	0	0	2.105.780	23.999.130	0	23.999.130	0

Konkluzion: Referuar të dhënave të raportimit të detyrimeve të prapambetura në MFE të cilat janë në shumën 23,999,130 lekë dhe llogarisë së detyrimeve të evidentuara në tepricat e llogarive të klasës 4 (llog.401, 467) në mbyllje të pasqyrave financiare viti 2024 në shumën 29,988,423 lekë konstatohet një diferencë në shumën 5,989,293 lekë. Sipas analizës së llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” diferenca prej 5,989,293 lekë i përket detyrimet e pagueshme ndaj të tretëve të konstatuara në muajin dhjetor 2024, të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për tu klasifikuar si detyrime të prapambetura, pasi nuk e kanë kaluar afatin 60-ditor që nga krijimi.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Delvine më datë 31.12.2024 janë të kuadruar me Degën e Thesarit Delvine , konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	37,530,019	Akt rakordimin me Degën e Thesarit	37,530,019	
-Granti nga buxheti	220,678,526	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	220,678,526	
-Financim i pritshëm nga buxheti	45,993,032	Sipas llogarisë 7206	45,993,032	
-Fonde buxhetore të trashëguara	59,107,487	Akt rakordim Degën e Thesarit	59,107,487	
-Të ardhura të trashëguara (rez)	0	Nga rezultati i vitit të mëparshëm llog.85		
-Llog 73 Ndryshim i gjendjes me(+)		Sipas llog 63 me (+)		
Totali të ardhura	363,309,064	Totali të ardhura	363,309,064	

Burimi: Bashkia Delvinë, përpunuar nga grupi i KLSH-së.

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas rakordimin me Degën e Thesarit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Lloji i taksës, tarifës	Fakti i Vitit 2023	Plani Viti 2024	Fakti i vitit 2024	Realizimi në % 2024
A	Te Ardhura nga Burimet e Veta	44,513,586	53,359,000	52,928,413	99%
A.1	Te ardhura nga taksat lokale	10,702,597	17,045,000	12,335,728	%
A.1.1	Taksa Vendore mbi biznesin e vogel	117,700	139,000	69,149	50%
A.1.2	Taksa mbi pasurine e paluajtshme	9,504,089	16,906,000	12,652,216	74%
A.1.2.1	Taksa mbi Ndertesen	3,382,792	3,110,000	5,362,431	172%
A.1.2.2	Taksa mbi token bujqesore	3,772,540	8,426,000	4,849,352	61%
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	2,348,757	2,550,000	2,440,433	96%
A.1.3	Taksa Vendore ne sherbimin hotelier	0	0	0	0%
A.1.4	Taksa ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	907,583	2,700,000	978,870	36%
A.1.5	Taksa e tabelës	173,225	120,000	117,500	98%
A.2	Te Ardhura nga taksat e ndara	8,593,157	7,100,000	10,673,444	150%
A.2.2	Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura	4,856,000	5,400,000	6,508,504	121%
A.2.3	Taksa e rentes minerare				0%
A.2.4	Taksa mbi te ardhurat personale	3,737,157	2,700,000	4,164,940	154%
A.3	Te Ardhura nga Tarifa Vendore (jo tatimore)	18,808,736	16,460,000	17,144,741	104%
A.3.1	Tarifa e Sherbimit Publik	6,759,118	8,900,000	8,668,061	97%
A.3.5	Tarifa per sherbimet administrative te bashkise	10,843,738	7,040,000	7,310,402	126%
A.3.5.1	Tarifa per sherbimet administrative te bashkise	249,400	340,000	267,800	79%
A.3.5.5	Tarifa e licensimit te veprimtarive te transportit	47,256	350,000	539,295	154%
A.3.5.6	Tarifa e parkimit per mjetet e licensuar e vendparkim publik	192,900	350,000	348,900	100%
A.3.5.7	Tarifa per licence tregtimin naftes bruto e nenproduktet e saj	0	0	0	0%
A.3.5.8	Tarifa per pyjet dhe kullotat	9,939,390	6,000,000	5,723,595	95%
A.3.5.9	Tarifa per sherbimet shtese nga zjarrfiksja	-	0	0	0%
A.3.5.10	Tarifa per zenien e perdorimin e hapësirës publike e fasadave	414,792	260,000	431,712	166%
A.3.6	Tarifa te institucioneve te arsimit,kultures,sportit etj	1,205,880	520,000	1,165,400	224%
	Qendra kulturore e fëmijëve	0			
A.3.6.8	Kopshtet	956,480	320,000	932,900	291%
A.3.6.9	Çerdhet	249,400	200,000	232,500	116%
A.3.10	Tarifa te tjera	0	0	0	0%
A.4	Te Ardhurat e tjera	6,409,096	12,754,000	12,774,500	100%
A.4.1	Qeraja nga asetet ne pronesi te bashkise	2,036,721	3,615,000	826,241	22%
A.4.7	Kundervajtjet administrative (Gjobat)	500,001	35,000	1,174,000	3354%
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdemtme	22,700	50,000	5,000	0%
A.4.14	Te tjera	3,849,674	9,054,000	10,769,259	118%
	TOTALI (A1+A2+A3+A4)	44,513,586	53,359,000	52,928,413	99%

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, përpunuar nga grupi i auditimit

Konkluzion: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në shumën 52,928 mijë lekë, nga 53,359 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 99%. Megjithëse krahasuar me vitin 2023 janë realizuar më shumë të ardhura për vlerën 8,414 mijë lekë, konstatohet se për disa taksat e tarifave planifikimi për vitin 2024 nuk ka marrë në konsideratë realizimin e këtij viti, pasi janë planifikuar me ulje si: tarifa për pyjet e kullotat, taksa mbi ndërtesën, taksa mbi të ardhurat personale, tarifat për kopshte e çerdhe, për të cilat konstatohet një realizim mbi 100% deri në 224%. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave konstatohet se për disa taksat dhe tarifave realizimi paraqitet në vlera të ulta si: taksa mbi tokën bujqësore në masën 61%; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 36%; taksa e tabelës në masën 98%; qiraja nga asetet ne pronesi te bashkise në masën

22%. Ky fakt tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është bërë mbi baza reale dhe realizimi i viteve të mëparshme nuk është marrë në konsideratë në planifikim dhe se për disa zëra të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/a, dhe 6.

Analizë: Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 363,309,064 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Delvinë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën **19,049,780 lekë**, i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 69,149 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 12,748,119 lekë e cila përfshin (taksë toke në vlerën 7,385,688 lekë, taksën mbi pasurinë në vlerën 5,362,431 lekë), e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 6,232,512 lekë e cila përfshin (taksë tabele në vlerën 117,500 lekë, taksë hapësirë publike në vlerën 431,712 lekë, taksë ndikimi në infrastrukturë në vlerën 978,870 lekë, taksë trualli në vlerën 2,440,433 lekë , tarife ujitje në vlerën 446,500 lekë, tarifa vendore për regjistrimin e veprimtarisë në vlerën 1,817,497 lekë), e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën **18,480,239 lekë**, i cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 7,583,100 lekë, e cila përfshin (Qira toke në vlerën 1,167,825 lekë, Qira trualli në vlerën 91,680 lekë, Qira Kullote në vlerën 5,723,595 lekë), i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7110 “Tarifë administrative dhe rregullatore”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 9,326,369 lekë, e cila përfshin (Taksë administrative në vlerën 267,800 lekë, Tarife leje transporti në vlerën 539,295 lekë, Tarifa te tjera 12,000 lekë, Tarifa shërbimi publik 8,507,274 lekë), i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë **7111 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh”** paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 1,570,770 lekë, e cila përfshin (Taksë parkimi në vlerën 348,900 lekë, Çerdhet në vlerën 250,050 lekë, Kopshte në vlerën 971,820 lekë), i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **72 “Grante Korente”** është në vlerën prej 325,779,045 lekë, vlerë e cila përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë 7200 “Nga buxheti për NJQP (Qendrore)” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 267,763,589 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 6,508,504 lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7204 “Pjesëmarrja e institucioneve në tatime nacionale” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 4,168,940 lekë, e cila përfshin (TAP në vlerën 4,168,940 lekë), i cili kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Gjendja e llogarisë 7207 “Sponsorizime” paraqitet në bilancin e 2024 në vlerën 1,348,980 lekë, e cila kuadron me Akt rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- **Ilog.7206** “Financim i pritshëm në vlerën 45,993,032 lekë vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në formatin nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Të ardhura të trashëguara në vlerën 59,107,487 lekë.

- Të ardhurat të hyra në llogarinë e Bashkisë sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Nr	Institucioni	Te ardhura nga buxheti		Te ardhurat e veta		Te ardhurat nga grantet që kanë shërbyer si burim financimi për kryerjen e shpenzimeve/investimeve gjatë vitit		Ketu mund te shtoni te ardhurat tjera që janë planifikuar/re realizuar nga bashkia		Total të ardhurat	
		Në lekë									
		Bashkia Delvinë.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan
1	Transferata e pakushtëzuar e përgjithshme	130,402,139	115,425,785							130,402,139	115,425,785
2	Te ardhurat e veta			60,207,613	59,777,046					60,207,613	59,777,046
3	Transferata e pakushtëzuar sektoriale	90,975,966	67,924,958							90,975,966	67,924,958
4	Fondi i Ndihmës Ekonomike, Invaliditetit dhe Moshat e treta	77,261,368	77,236,290							77,261,368	77,236,290
5	Fonde te deleguara për Gjendjen Civile	3,656,000	3,525,477							3,656,000	3,525,477
6	Transferata të kushtëzuara për investime, shpenzime operative					42,741,625	42,733,754			42,741,625	42,733,754
	Shuma	302,295,473	264,112,510	60,207,613	59,777,046	42,741,625	42,733,754			405,244,711	366,623,310

2.2 Shpenzimet

Shpenzimet përfaqësojnë pakësim të përfitimeve ekonomike gjatë ushtrimit kontabël, në formën e daljes apo të pakësimit të vlerave të aktiveve apo rritjen e detyrimeve. Shpenzimet janë flukse dalëse gjatë periudhës raportuese, që kanë për rezultat zvogëlimin e kapitaleve të veta (fondeve), përfaqësojnë investimin që kryen njësia e qeverisjes së përgjithshme për realizimin e synimeve të tij të funksionimit gjatë një viti ushtrimor.

Buxheti vjetor i vitit 2024 është miratuar me VKB nr. 47, datë 22.12.2023, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2/1, datë 10.01.2024, i ndryshuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024 sipas akordimit të burimeve të financimit dhe llogarive ekonomike të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Institucioni	Te ardhura nga buxheti						Te ardhurat nga grantet dhe kreditë për financimin e shpenzimeve/investimeve gjatë vitit	Te ardhura te tjera që janë planifikuar/realizuar nga subjekti		Total te ardhurat		
	Transferata pakushtëzuar		Transferata e pakushtëzuar sektoriale		Transferata e kushtëzuar			Plan	Fakt	Plan	Fakt	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt						
Akordimi I te Ardhurave	130,402,139		90,975,966		123,658,993		60,207,613			405,244,711		
a- Te trashëguara	19,319,232		20,791,965				6,848,633			46,959,830		
b- Te viti	111,082,907		70,184,001		123,658,993		53,358,980			358,284,881		
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Shp paga (600)	69,508,205	66,926,831	53,987,223	49,331,838	3,133,000	3,020,984	22,735,000	22,304,433			149,363,428	141,584,086
Shp sig shoq/shënd (601)	13,337,000	12,409,573	10,136,000	8,817,539	523,000	504,493	0	0			23,996,000	21,731,605
Shp mall/sherb (602)	31,244,934	23,141,381	14,854,743	7,575,581	1,317,600	1,317,600	30,047,137	30,047,137			77,464,414	62,081,699
Transf tek organiz (604)	0	0	0	0	2,137,867	2,129,997	463,476	463,476			2,601,343	2,593,473
Transf tek ind (606)	0	0	0	0	77,261,368	77,236,290	0	0			77,261,368	77,236,290
Fondi rezervë (609)	0	0	0	0			1,500,000	1,500,000			1,500,000	1,500,000
Shp investime (230)	0	0	0	0			0	0			0	0
Shp investime (231)	16,312,000	12,948,000	11,998,000	2,200,000	39,286,158	39,286,157	5,462,000	5,462,000			73,058,158	59,896,157
Total	130,402,139	115,425,785	90,975,966	67,924,958	123,658,993	123,495,521	60,207,613	59,777,046	-	-	405,244,711	366,623,310

Niveli i realizimit të buxhetit vjetor 2024 referuar akt-rakordimit me thesarin sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2024	Plani përfundimtar 2024	Plani i çelur 2024	Realizimi i shpenzimeve 2024	% e realizimit/ Planit Përfundimtar
Shpenzime për paga (600)	139,832,785	149,363,428	148,940,731	131,643,897	88%
Shpenzime për sig shoq e shëndetësore (601)	23,297,000	23,996,000	23,996,000	21,731,605	91%
Shpenzime operative (602)	64,378,060	77,464,414	77,464,414	54,864,408	71%
Transferta tek organizatat (604)	2,637,867	2,601,343	2,593,473	2,575,258	99%
Transferta tek individët (606)	77,261,368	77,261,368	77,261,368	77,236,290	99%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	1,500,000	1,500,000	1,500,000	0	0%
Shpenzime per Oponenca teknike (230)	0	0	0	0	0%
Shpenzime per Investime (231)	62,486,158	73,058,158	73,058,158	57,491,727	79%
a. Nga të ardhurat dhe transferata e pakushtëzuar			281,155,151	222,047,664	79%
b.Nga Ministritë linjes			123,658,993	123,495,521	99%
TOTAL	371,393,238	405,244,711	404,814,144	345,543,185	85%
a.Nga të ardhurat dhe transferata e pakushtëzuar	247,734,245	281,585,718	281,155,151	222,047,664	79%
b.Fonde për termetin	0	0	0	0	0
c.Nga Ministritë linjes	123,658,993	123,658,993	123,658,993	123,495,521	99%
TOTAL	371,393,238	405,244,711	404,814,711	345,543,185	85%

Burimi: Drejtoria e Financës i përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2024 rezulton se, fondet buxhetore janë realizuar në shumën 345,543,185 lekë, nga 404,814,711 lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar:

a- Mosrealizimi i fondeve në llogaritë, llog.602 “Shpenzime për mallra dhe shërbime” në masën 71%.

b- Llog.231 “Shpenzimet për investime” me financim nga buxheti i bashkisë dhe transferata e kushtëzuar janë realizuar në masën 79%. Ky zë rezulton i realizuar në nivel të ulët për arsye se fondet për investime me burim financimi të ardhurat e veta dhe transferata e pakushtëzuar janë realizuar në masën 60% për arsye se një pjesë e investimeve janë prokuruar në fund të vitit 2024, duke mos u financuar ose financuar pjesërisht gjatë vitit 2024. Një pjesë e projekteve nuk janë realizuar. Investimet me burim financimi nga Transferatat e kushtëzuara (ministritë e linjës) janë realizuar në masën 99%.

▪ Mbi të ardhurat e trashëguara

Në lekë

Emërtimi	Të ardhurat e trashëguara të vitit paraardhës 2023	Të ardhurat e vitit 2024	Të ardhurat nga Fondi i Rindërtimit	Shpenzimet e vitit 2024	Te ardhura që mbeten për tu trashëguar në vitin pasardhës 2025
Bashkia Delvinë	49,959,830	234,195,321	0	222,047,664	59,107,487
Nga këto:					
-Transf.Pakushtëzuar	19,319,232	111,082,907		115,425,785	14,976,354
-Transf.Sektoriale	20,791,965	70,184,001		67,924,958	23,051,008
-Të Ardhura Vendore	6,848,633	52,928,413		38,696,921	21,080,125
-Fonde për Rindërtimin	0	0		0	

Referuar të dhënave të ardhurave të trashëguara mbështet edhe një herë faktin se Bashkia Delvinë ka patur fonde në dispozicion për rritjen e performancës së realizimit të investimeve dhe nuk ka argument justifikues për realizimin në nivele aq të ulët të fondeve për investime, përveç mungesës së kapaciteteve dhe punës së pa mjaftueshme për vënien në eficiencë të fondeve brenda vitit ushtrimor dhe rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon.

Buxheti i detajuar sipas burimeve të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Transferta	Fakt 2024	Pesha specifike ne totalin e shpenzimeve faktike
Transferta e pakushtëzuar	115,425,785	33,4%
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	67,924,958	19,7%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	38,696,921	11,2%
Transferta e kushtëzuar	123,495,521	35,7%
Totali	345,543,185	100%

Referuar të dhënave për vitin 2024 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 38,697 mijë lekë, ose në masën 11,2 %, nga transferta e pakushtëzuar në shumën 115,426 mijë lekë, ose në masën 33,4 %, transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 67,925 mijë lekë, ose në masën 19,7 %, transferta e kushtëzuar në shumën 123,543 mijë lekë ose në masën 35,7%.

▪ Vështirësia financiare

Në lekë

Nr	Subjekti	Transferrat e pakushtëzuar + ardhurat vendore	Transferrat për Rindërtimin	Fondet e kushtëzuara	Stoku i detyrimeve të prapambetura	Huatë	Statusi i gjendjes financiare i raportuar	Te ardhurat e paperdorura për vitin 2024	Shpenzimet e realizuara për vitin 2024	Shpenzimet e miratuara për vitin 2024
Bashkia Delvinë (1+2)		281,155,151		123,495,521	23,999,130			59,107,487	302,809,431	362,072,519
1	Fondet e Bashkisë	281,155,151				0	7.93%	59,107,487	222,047,664	281,155,151
1.1	Burimet e veta									
-	Transferta e pakushtëzuar	130,402,139						14,976,354	115,425,785	130,402,139
-	Transferta sektoriale	90,975,967						23,051,008	67,924,958	90,975,967
-	Të ardhurat vendore	59,777,046			23,999,130			21,080,125	38,696,921	59,777,046
1.2	Fonde për Rindërtimin									
2	Fondet e Kushtëzuara	0		123,495,521					80,809,431	80,917,368

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2024 paraqiten në vlerën 23,999,130 lekë dhe pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 7.93 % kundrejt fondeve faktik prej **302,809,431**lekë. Kjo situatë tregon se Bashkia Delvinë konsiderohet në situatë normale të gjendjes financiare, pasi nuk e ka kaluar pragun 15% në fund të vitit ushtrimor. Gjithashtu raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore faktike për shpenzime është nën nivelin prej 25%, kështu duke mos u konsideruar institucion në vështirësi financiare sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimit e MF nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33. Raportimi i detyrimeve në Ministrinë e Financës është bërë me shkresën nr. 387prot., datë 17.02.2025.

Në lekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzi me vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrësesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrësesh financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	23,999,130		7.93%
Llog ekon	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqësore	1,246,638		
4864200	Det.Prap. Shërbime	3,049,850		
4864201	D.P.Energji Elektirke	2,105,780		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	0		
4864400	Det.Prap. Investime	17,596,862		
4864500	Det.Prap.Rimbursim t.v.sh.	0		
4864600	Mallra			

4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet		0	
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal		0	
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera		0	
4864901	Paga		0	
4864902	Shpronetime		0	
4864903	Transferime te individët		0	
4864904	Transferime te Subjektet		0	
III	Totali (I+II)	23,999,130	302,809,431	7,93%

- Raportet e monitorimit.

Për vitin 2024 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit. **Për vitin 2024** janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:

- “Raport monitorimi janar-prill 2024” me shkresën nr. 1154prot., datë 27.05.2024;
- “Raport monitorimi janar-gusht 2024” me shkresën nr. 2163prot., datë 30.09.2024;
- ‘Raport monitorimi janar-dhjetor 2024 me shkresën nr. 468prot., datë 27.02.2025.

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezulton se në to janë pasqyruar saktë treguesit e realizimit të buxhetit referuar dhe akt akordimit me degën e thesarit. Po kështu këto të dhëna janë pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë, si në tabelën e mëposhtme:

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2023	Detyrime të vitit 2024	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	131,643,897	9,964,018	13,537,378	135,217,257
601	21,731,605	1,626,285	2,241,972	22,347,292
602	54,862,408	2,304,416	10,134,671	62,694,663
603		0	0	0
651		0	.0	0
604	2,575,258	132,119	19,795	2,462,934
63 Ndryshimi I gjendjes	0			-3,218,996
606	77,236,290			77,236,290
466	774,770			0
231	57,491,727			0
Operacione te korrjgimit te rezultatit	0			7,462,137
Totali	346,317,955	14,026,838	25,933,816	304,201,577

Burimi: Përpunuar nga grupi i KLSH-së.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën **304,201,577** lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 “Paga, shpërblime e të tjera personeli” për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 135,217,257 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.
- Gjendja e llogarisë 601 “Kontribute për sigurime” për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 22,347,292 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.
- Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 62,694,663 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 2,462,934 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 77,236,290 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me thesarin.
- Gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2024 është në vlerën -3,218,996 lekë.
- Gjendja e shpenzimeve të tjera “Operacione të korrjgimit të rezultatit” për vitin 2024 paraqitet në bilanc në vlerën 7,462,137 lekë.

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 363,309,064 lekë dhe totali shpenzimeve është 304,201,577 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 59,107,487 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatit e ushtrimit".

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit".

-Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën **57,491,727** lekë në analizë tregon burimet e investimit nga buxheti i shtetit në vlerën **57,491,727** lekë.

Nga testi kontrollit për vitet 2023 dhe 2024 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 gjerat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të vendimit nr. 290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të Programit të Auditimit u auditua "Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së".

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Delvinë, nga KLSH me shkresën nr. 432/6prot., datë 15.07.2024, bërë hyrje në Bashkinë Delvinë me shkresën nr.1630 datë 16.07.2023 për periudhën e auditimit 01.01.2023-31.12.2023, janë marrë masat dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht: Në zbatim të nenit 15, shkronja j, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.01.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nga ana e Bashkisë Delvinë është hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së. Plan Veprimi ka përfshirë të gjitha masat organizative, masat për shpërblim dëmi, masat për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve, masat administrative dhe masat disiplinore të renditura sipas nivelit të riskut. Janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohore

të përcaktuar referuar urdhrit nr. 1630/1, datë 05.08.2024 të Kryetarit të Bashkisë Delvinë “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar. Plan Veprimi u është dërguar Këshillit Bashkiak dhe 10 (dhjetë) strukturave përgjegjëse, Drejtori, Ndërmarrje, Inspektorate e Sektorë që të bëjnë analizë të punës së tyre, me qëllim përmirësimin e punëve në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Një kopje e Plan Veprimit është dërguar dhe në KLSH, me shkresën nr. 1630/1, datë 05.08.2024 të Bashkisë Delvinë, pra **brenda 20 ditëve** nga marrja e Rekomandimeve, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ndërsa, me shkresën nr. 1630/3, datë 23.01.2025 është dërguar në KLSH zbatimi i Plan Veprimit dhe ecuria e zbatimit të rekomandimeve, pra **brenda afatit 6 mujor** nga marrja njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe Rekomandimeve.

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Delvinë, nga KLSH me shkresën nr. 432/6prot., datë 15.07.2024, në mënyrë përmbledhëse realizimi është si më poshtë:

-Nga 14 masa gjithsej të rekomanduara, janë pranuar plotësisht të 14 masat, ndërsa zbatimi i tyre paraqitet si më poshtë:

-Nga 10 masa organizative janë zbatuar 6 masa, janë në proces 2 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative;

-Nga 2 Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) janë pranuar të 2 masat të cilat janë në pjesërisht të zbatuara;

- 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, rezultojnë në proces;

-Për një masë disiplinore, lënë në kopetencë të Kryetarit të Bashkisë, rezultojnë se janë dhënë gjithsej 3 (2 tërheqje vëmendjeje dhe 1 i larguar), pra është realizuar.

Më hollësisht zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së paraqitet si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, si dhe të rishikuar përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi, si për investimet ashtu edhe për shpenzimet për mallra e shërbime.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh nga të gjitha Drejtoritë, Sektorët dhe EMP-të për të hartuar dhe planifikuar buxhetin e vitit në mënyrë të kujdesshme përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi, si për investimet, ashtu edhe për shpenzimet për mallra shërbimi.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht se bashkia me strukturat e saj kanë kryer një proces planifikimi të buxhetimit që ka kaluar nëpër të gjitha hallkat e miratimit, për vitin 2024 realizimi paraqitet në masën 85%, ku në këtë masë realizimi ka ndikua kryesisht mosrealizimi i fondeve për “Shpenzime për mallra dhe shërbime”, llogaria 602 dhe i “Shpenzimet për investime”, llogaria 231, si rezultat i zhvillimit të prokurimeve në fund të vitit dhe që mbeten të pa financuara.

Statusi: Zbatuar.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë dhe Sektori i Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh gjatë gjithë vitit 2024 ulja e detyrimeve të prapambetura e cila nga vlera 32.753.302 lekë në çelje të vitit është ulur në vlerën

23.999.130 lekë me 8,754,172 lekë, ose në masën prej 26,7%, duke e çuar situatën e bashkisë në normalitet financiar.

Statusi: Zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Delvinë të marrë masa që të bëjë një analizë të hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme me realizimin e shpenzimeve buxhetore.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh planifikimi sa më real i të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme me realizimin e shpenzimeve buxhetore. Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 60,207,613 lekë dhe është realizuar 59,707,046 lekë, ose në masën prej 99%.

Statusi: Zbatuar.

4.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Delvinë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHKT Bashkia Delvinë dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjor për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës), si dhe të vijojë puna më grupe pune në mungesë të informacionit zyrtarë për evidentimin në terren të sipërfaqeve të ndërtimit për taksën e pasurisë.

Pretendimet e subjektit: Është marrë parasysh rekomandimi dhe po punohet në vijim në zbatim të masave të lëna nga Sektori i Taksave, Tarifave, në Bashkinë Delvinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHKT Bashkia Delvinë dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme.

Statusi: Proces.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2024, të bëjë sistemimin e vlerës 6,153,237 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 6 automjeteve të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është zbatuar në mbylljen e pasqyrave financiare vjetore 2024 sistemimi i vlerës 6,153,237 lekë nga llogaria 215 “Mjete transporti”, në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Statusi: Zbatuar.

6.1.Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Delvinë me vlerë nominale 465.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 46,500,000 lekë dhe Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A me 5.28% të aksioneve me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 5,280 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet, deri në transferimin përfundimtar të aksioneve dhe marrjes në dorëzim të tyre.

Pretendimet e subjektit: Nëpunësi Zbatues, ka zbatuar në mbylljen e pasqyrave financiare vjetore 2024 sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Delvinë me vlerë nominale 465.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 46,500,000 lekë dhe Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A me 5.28% të aksioneve me vlerë nominale 100.000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 5,280 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet, deri në transferimin përfundimtar të aksioneve dhe marrjes në dorëzim të tyre.

Statusi: Zbatuar.

7.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes dhe numrit të aseteve të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë

përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me certifikatë pronësie.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh dhe në buxhetin e vitit 2025 janë parashikuar shpenzime për hipotekimin e aseteve që janë transferuar bashkisë.

Statusi: Proces.

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

8.1.Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Delvinë dhe menaxhimi i lartë, të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e auditimit të Brendshëm duke filluar procedurat e rekrutimit të punonjësve.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh, por nuk janë parashikuar si pozicione në strukturë.

Statusi: Pazbatuar.

2.2. Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Delvinë, në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëres nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikën e ngjashme nga bashki të tjera.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh, Bashkia Delvinë është në bashkëbisedime me Bashkinë Sarandë për të finalizuar një Akt-Marrëveshje të përbashkët për strukturën e auditimit.

Statusi: Pazbatuar.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Sociale dhe Arsimit në Bashkinë Delvinë, Sektorin e të ardhurave, të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse dhe të ardhurave fiskale. Të respektohet likuidimi me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh që mos të krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit. Bashkëlidhur raporti i realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024.

Statusi: Zbatuar.

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1.Rekomandimi: Bashkia Delvinë të marrë masa të nxjerrë në shitje aksionet që zotëron në shoqërinë “Klubi i Futbollit Delvina”, sha në përputhje me parashikimet e ligjore “Për Sportin”.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh nxjerrja në shitje e aksioneve që zotëron në shoqërinë “Klubi i Futbollit Delvina”, procedurë që është parashikuar të kryhet në vitin

2025.

Statusi: Proces.

MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Delvinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifavat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën **68,016,302 lekë**.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh dhe janë njoftuar subjektet debitorë si dhe është arkëtuar vlera 1,651,611 lekë.

-Për subjektet është arkëtuar vlera 228,781 lekë.

-Për abonentët familjarë është arkëtuar vlera 1,422,830 lekë.

Statusi: Proces zbatimi.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Delvinë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **807,508 lekë**.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh dhe është arkëtuar vlera 202,654 lekë.

Nr	Emër	Atësia	Mbiemër	Data	Nr mandate Bankar	Vlera e taksës (lekë)	Pa Paguar	Paguar
1	B	L	L	04.01.2023	504ATHD2310190001	9495	9495	
2	I	V	T	04.01.2023	504ATHD230190001	40433	40433	
3	A	L	K	04.01.2023		16370		16370
4	H	R	K	31.01.2023	A0001/00015/HAD	44361	44361	
5	A	A	H	31.01.2023		61549		61549
6	B	S	I	31.01.2023	A0001/415STHD2304100	16370	16370	
7	F	B	S	31.01.2023		27173	27173	
8	F	S	A	31.01.2023		17352	17352	
9	L	D		31.01.2023		16042		16042
10	S	K	G	02.02.2023	504ATHD230380001	12768	12768	
11	G	V	S	02.02.2023	504ATHD230450001	31102	31102	
12	K	V	S	02.02.2023	504ATHD230440001	66460	66460	
13	D	V	S	02.02.2023		27010	27010	
14	L	I	B	13.02.2023	504ATHDD230480001	91178	91178	
15	G	Sh	K	28.02.2023		107875	107875	
16	Q	D	K	13.02.2023		10313		10313
17	V	B	V	13.03.2023	504ATHD230820003	16697	16697	
18	P	Ll	T	17.03.2023		44198	44198	
19	M	P	K	17.03.2023	A0001/00043/HAD	3765	3765	
20	Sh	R	D	31.03.2023	504ATHD231080005	48617	48617	
21	A	M	Sh	31.03.2023		15551		15551
22	Th	Xh	P	31.03.2023		43870		43870
23	E	M	D	06.04.2023		23081		23081
24	E	L	R	10.10.2023		6711		6711
25	A	M	Sh	20.12.2023		9167		9167
	SHUMA							202654

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 gjerat b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 gjerat b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Delvinë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së,

të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Pretendimet e subjektit: Referuar rekomandimit është marrë parasysh, bazuar në performancën secilit punonjës dhe shkeljeve të rekomanduara janë kryer gjithë procedurat, me shkresën nr.1104/2prot., datë 12.08.2024, janë dhënë gjithsej 3 (2 tërheqje vëmendjeje dhe 1 i larguar).

Statusi: Zbatuar.

2. 4 Të tjera çështje përgjatë auditimit.

Gjatë kryerjes së fazës së auditimit në teren nuk rezultuan çështje të tjera për auditim.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Nuk janë përcaktuar objektiva konkretë, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Ka strategji të menaxhimit të riskut dhe regjistër risku, por procesi i menaxhimit të riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar. Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Sektori i Tatim Taksave nuk përdorin programe për mbajtjen e kontabilitetit, por operojnë me programin Excel, ku niveli i riskut për të gabuar është evident. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin e duke mos e vlerësuar në mënyrë periodike. Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS, AFMIS etj.) si dhe nuk ka procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up), apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 11-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të kontrollit të brendshëm, për hartimin dhe miratimin e procedurave të shkruara për raportimin e shkeljeve të etikës dhe trajtimin e rasteve të mundshme të korrupsionit, si dhe krijimin e një mekanizmi të qartë për menaxhimin e këtyre ankesave në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale. Hartimin e një plani vjetor të rekrutimit dhe trajnimit të stafit, të bazuar në një analizë të nevojave reale të burimeve njerëzore dhe objektivave strategjike të institucionit. Vendosijen e një sistemi të brendshëm raportimi për shkeljet, që lejon identifikimin dhe reagimin në kohë ndaj çështjeve të ndjeshme. Investime në sisteme funksionale IT që plotësojnë nevojat specifike të bashkisë dhe ndërtimin e një politike për rikuperimin dhe ruajtjen e të dhënave (data back-up), për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e

funksioneve administrative dhe financiare. Përgatitjen e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, në Bashkinë Delvinë nuk është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe as nuk është arritur marrëveshje për kryerjen e shërbimit të auditimit me kontraktim nga një bashki e afërt, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë kjo njësi publike nuk i është nënshtruar procesit të auditimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 11-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për të krijuar sa më parë Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Delvinë.

Gjithashtu, në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, të shikohen mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëjës nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikën e ngjashme nga bashki të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” rezultoi në vlera të konsiderueshme, e akumuluar ndër vite për subjekte të mbyllura apo subjekte që kanë ndërruar jetë, në shumën 34,230,884 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga debitorë si më poshtë:

a. Debitorë e biznesit të vogël për tatimet dhe taksat 167 subjekte, në vlerën 7,443,206 lekë;

b. Debitorë të biznesit të madh për tatimet dhe taksat 2 subjekte në vlerën 26,787,678 lekë.

Gjendja e këtij zëri, në fund të vitit 2023 ishte në vlerën 90,254,844 lekë dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 93,304,193 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimit Taksave dhe Sektorin Juridik, të marrin masa sipas përcaktimeve ligjore për arkëtimin e detyrimeve “debitorë tatimet dhe taksat” për vlerën 93,304,193 lekë.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2024, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, paraqitet në vlerën kontabël 12,163,708 lekë, e rakorduar me degën e thesarit dhe përbëhet nga 16 subjekte. Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2024 janë plotësuar afatet kontraktuale për likuidimin të vlerës së garancisë në shumën 2,095,237 lekë. Referuar veprimeve të ditarit të marrëdhënieve me thesarin rezultoi se gjatë vitit është likuiduar shuma 1,273,002 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 822,235 lekë. Për fondet e ngurtësuara të cilave u ka kaluar afati i disbursimit si pasojë e mbylljes së periudhës së garancisë së punimeve nuk ka pasur kërkesa pranë Bashkisë nga subjektet sipërmarrëse të investimeve për zhbllokimin e tyre. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Njësia Autorizues dhe Njësia Zbatues i bashkisë, të marrin masa për të zbatuar procedurat ligjore për likuidimin e vlerës 822,235 lekë, sipas subjekteve përkatëse dhe kontratave që këto subjekte kanë me njësinë vendore.

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Delvinë ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 12,852.¹⁶ ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020. Bashkisë Delvinë i kanë kaluar në pronësi/përdorim aktualisht 391 prona të transferuara nga lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave. Në Zyrën Vendore të ASHK Sarandë rezultojnë se janë çelur kartela të pasurive të paluajtshme për 416 pasuri pyje dhe kullota, për të cilat Bashkia Delvinë ka aplikuar vetëm për 9 (nëntë) pasuri. Nuk ka aplikuar për certifikatë pasurie gjatë vitit 2024, me arsyetimin për mungesë fondesh të planifikuara për këtë qëllim, veprime këto në kundërshtim me nenin 37 të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe me VKM nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Delvinë nëpërmjet strukturave të administrimit të aseteve, të marrë masa të menjëhershme për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur për regjistrimin e aseteve në ASHK, ndërsa nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogariten kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Brenda datës 31.12.2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi treguesit e të ardhurave nga taksat dhe tarifat, rezultoi se janë realizuar në shumën 52,928 mijë lekë, nga 53,359 mijë lekë të parashikuara, ose në masën 99%. Megjithëse krahasuar me vitin 2023 janë realizuar më shumë të ardhura për vlerën 8,414 mijë lekë, u konstatua se për disa taksa e tarifa planifikimi për vitin 2024 nuk ka marrë në konsideratë realizimin e vitit paraardhës, pasi janë planifikuar me ulje si: tarifa për pyjet e kullotat, taksa mbi ndërtesën, taksa mbi të ardhurat personale, tarifat për kopshte e çerdhe, për të cilat u konstatua një realizim mbi 100% pra 224%. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave u konstatua se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta si: taksa mbi tokën bujqësore në masën 61%; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në masën 36%; taksa e tabelës në masën 98%; qiraja nga asetet në pronësi të bashkisë në masën 22%. Kjo tregon se planifikimi i të ardhurave në disa zëra të ardhurash nuk është bërë mbi baza reale dhe nuk është marrë në konsideratë në planifikim realizimi i viteve të mëparshme, dhe se për disa zëra të ardhurash nuk është bërë punë e mjaftueshme për arkëtimin e tyre, gjë që ka sjellë ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 5/a, dhe 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të kryej parashikime bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse, me qëllim pasqyrimin real të situatës së të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e vëna në dispozicion mbi treguesit e buxhetit për vitin 2024, rezultoi se shpenzimet buxhetore janë realizuar në shumën 345,543,185 lekë, nga 404,814,711 lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar:

- Mosrealizimi i fondeve për “Shpenzime për mallra dhe shërbime”, llogaria 602, ose realizimi në masën 71%;

- Realizimi i “Shpenzimet për investime”, llogaria 231, me financim nga buxheti i bashkisë dhe transferta e kushtëzuar në masën 79%. Ky zë rezultoi i realizuar në nivel të ulët për arsye se fondet për investime me burim financimi të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar janë realizuar në masën 60%, pasi një pjesë e investimeve janë prokuruar në fund të vitit 2024, duke mos u financuar ose financuar pjesërisht gjatë vitit 2024, ndërsa disa prej projekteve nuk janë realizuar. Investimet me burim financimi nga transferta e kushtëzuar (ministritë e linjës) janë realizuar në masën 99%. Referuar të dhënave të të ardhurave të trashëguara, të cilat në fund të vitit 2024 kanë qenë në shumën 59,107 mijë lekë, mbështetet fakti se Bashkia Delvinë ka patur fonde në dispozicion për rritjen e performancës së realizimit të investimeve dhe nuk ka argumente justifikues për realizimin në nivele të ulët të fondeve, përveç mungesës së kapaciteteve dhe punës së pa mjaftueshme për vënien në eficiencë të fondeve brenda vitit ushtrimor për rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit, në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të shpenzimeve, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre treguesve, rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe punës së strukturave të bashkisë të punohet për vënien në eficiencë të fondeve brenda vitit ushtrimor dhe rritjen e shërbimeve ndaj komunitetit, në mënyrë që buxheti të jetë koherent me periudhën që financon.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e financiar” për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, rezulton se janë lënë gjithsej 14 rekomandime prej të cilave: 10 masa organizative, 2 masa për uljen e borxhit tatimor, një masë për eliminimin e efekteve negative dhe 1 masë disiplinore në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, të cilat janë pranuar nga subjekti i audituar.

Bashkia Delvinë brenda afatit 20 ditor nga marrja e rekomandimeve, në zbatim të nenit 15, shkronja j, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.01.2014” Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së dhe me shkresën nr. 1630/1, datë 05.08.2024 e ka dërguar në KLSH.

Me shkresën nr. 1630/3, datë 23.01.2025, referuar nenit 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, brenda afatit 6 mujor nga marrja njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe rekomandimeve, bashkia ka dërguar raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Delvinë, nga KLSH me shkresën nr. 432/6 prot., datë 15.07.2024, të cilat përgjithësisht janë të njëjta me konstatimet e rekomandimet e këtij auditimi, rezulton se nga 14 masa të dhëna gjithsej, janë realizuar 7 masa, janë në proces 3 masa, janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa. Në mënyrë të përmblodhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

-Nga 10 masa organizative janë zbatuar 6 masa, konkretisht: rekomandimi 1.1; 2.1; 3.1; 5.1; 6.1, si dhe rekomandimi 3.1, lënë në auditimet e viteve të kaluara, rekomandime të cilat e kanë humbur koherencën e tyre. Janë në proces 2 rekomandime, përkatësisht, rekomandimi 4.1 dhe 7.1, si dhe nuk

janë zbatuar 2 masa organizative të lëna në auditimet e viteve të kaluara, përkatësisht: rekomandimi 1.1 dhe 2.1;

- 2 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), 1 masë është në proces zbatimi dhe një masë është pjesërisht e zbatuar;

- 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, rezulton në proces;

-Për një masë disiplinore, lënë në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, rezulton se është realizuar, pasi janë dhënë gjithsej 3 masa (2 tërheqje vëmendjeje dhe 1 i larguar). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 42-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe të marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave pjesërisht të zbatuara, të pa zbatuara dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

Masat Organizative

A.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1.Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Delvinë dhe menaxhimi i lartë, të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e auditimit të Brendshëm duke filluar procedurat e rekrutimit të punonjësve.

Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Taksave, Tarifave, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Delvinë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 807,508 lekë.

Menjëherë

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion rezultoi se, ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë për taksat dhe tarifave vendore, ku në fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 90,254,844 lekë, shtesat gjatë vitit 2024 janë në shumën **18,152,790** lekë, janë kryer arkëtime në shumën 15,103,441 lekë, ndërsa detyrimet progresive në fund të vitit 2024 janë **në shumën 93,304,193 lekë**, pra me rritje e cila vjen kryesisht nga detyrimet debitore nga biznesit i madh dhe i vogël në, të cilat kanë një rritje **në shumën 13,118,668 lekë**.

Mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga taksapaguesit debitorë ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Delvinë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenet 6 dhe neni 9, pika 1.3.

Nga Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Delvinë për vjeljen e detyrimeve është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e njoftim-vlerësim detyrimit, e vendosjen e një gjobe dhe nuk është aplikuar asnjë masë tjetër shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me VKB nr. 104, datë 04.12.2023 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe kundërvajtjet administrative për vitin 2024”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët e vitit 2024 në shumën 13,118,668 lekë, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e debitorëve për taksa e tatime gjithsej në shumën **93,304,193 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.